

RAPORT I AUDITORES TE PAVARUR
PER AUDITIMIN LIGJOR TE FONDEVE TE PERFITUAR DHE TE
SHPENZUARA
FUSHATA ZGJEDHORE PER ZGJEDHJET VENDORE TE SHQIPERISE 2015
PERIUDHA 21.06.2015

RAPORTI I AUDITIT TË PAVARUR PËR QËLLIME TË VEÇANTA
PËR AUDITIMIN E FONDEVE TË PËRFITUARA DHE TË SHPENJUARA NGA
PARTIA
"ALEANCA DEMOKRATIKE SHQIPTARE"

Tirane më, 8 Nentor 2015

Tabela e përmbajtjes

Raporti i veçante i Auditit te Pavarur	3
Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve (Financimet, Donacionet dhe Përdorimi I fondeve sipas destinacionit).....	5
Informacione te pergjithshme.....	6

Referencat ligjore:

Për kryerjen e këtij misioni jemi mbështetur në përputhje me:

- Standartet Ndërkombëtare të Auditimit me referencë të veçantë SNA 800.
- Ligjin nr.10019.datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë"
- Ligjin nr.10091.datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe Kontabilistit të Miratuar"
- Ligjin Nr. 9228 datë 29.04.2004 „Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"
- Çdo dokument ligjor të marrë pranë Partisë.

RAPORT I AUDITORIT TE PAVARUR
PER AUDITIMIN LIGJOR TE FONDEVE TE PERFITUAR DHE TE
SHPENZUARA
FUSHATA ZGJEDHORE PER ZDHEJDHET VENDORE TE SHQIPERISE 2015
PERIUDHA 21.06.2015

Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve

Unë kam audituar pasqyrën (deklaratën) bashkëlidhur të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore të Partisë Aleanca Demokratike Shqiptare për zgjedhjet vendore të Shqipërisë për periudhën 21.06.2015.

Pasqyra është pergjegjesi e drejtimit të subjektit zgjedhor Partia Aleanca Demokratike Shqiptare.

Kjo pasqyrë (deklarata) është përgatitur nga Partia Aleanca Demokratike Shqiptare bazuar në librin e llogarive të Partisë dhe të rregjistrit të posaçëm, miratuar si model me vendimin e KQZ-së, të cilët janë mbajtur për të pasqyruar të gjitha transaksionet në lidhje me fushatën zgjedhore, që kanë dhënë bazën për përgatitjen e pasqyrës së arkëtimit – pagesave.

Përgjegjësia ime është të shpreh një opinion mbi këtë pasqyrë bazuar në auditimin tim.

Unë kam kryer auditimin në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit në referencë të veçantë me SNA 800 "Konsiderata të vecanta – auditimet e pasqyrave financiare të përgatitura sipas kuadrove për qelime specifike". Këto standarte kërkojnë që unë të veproj në pajtim me kërkesat e etikës dhe të planifikoj e të kryej auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për faktin që pasqyrat financiare të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore për zgjedhjet parlamentare të kuvendit të Shqipërisë të mos përmbajnë anomali materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit për shumat dhe deklarimet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura janë në gjykimin e audituesit, duke përfshirë vlerësimin e rrezikut të anomalive materiale, ofte si rezultat i mashtrimeve apo gabimeve.

Gjatë vlerësimit të këtyre rreziqeve, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm të Partisë në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare, me qëllim që ai të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të nevojshme për rrethanat financiare, por jo me qëllimin që të shprehë një opinion për efektivitetin e kontrollit të brendshëm të partisë.

Auditimi përfshin gjithashtu shqyrtimin mbi bazën e testeve, të fakteve që mbështesin shumat dhe deklarimet në pasqyrat financiare, vlerësimin e përshtatshmërisë së metodave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi i Partisë si dhe me vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Unë çmoj se evidenca e auditimit që unë kam siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë opinionin tim të auditimit.

Ne opinionin tone, pasqyra e bashkëlidhur e fondeve të përfituar dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore për zgjedhjet lokale të Partisë Aleanca Demokratike Shqiptare e datës 21.06.2015, është përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kërkesat e raportimit mbi bazën arkëtimeve dhe pagesave konform me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 i ndryshuar 'Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare'.

ERK AUDITING SHPK

Eksperti Kontabel i Regjistruar

Theodharaq GJOSHA Nr LIC 069



Data 08.11.2015

Adresa: Bul. "At Gjergj Fishta" K5, Ap7
Tirane

Cel: +355 69 20 54541

E-mail: raqigjosh@yahoo.com

Deklarate e arketimit dhe pagesave e Partise "ALEANCA DEMOKRATIKE SHOIPTARE"
per periudhen zgjedhore 21/06/2015

Pershkrimi sipas burimit dhe natyres se shpenzimit	Periudha
Burimet(te ardhurat) nga:	
Kuota e antaresise	lek
Fonde publike nga shteti	lek
Dhurime nga persona fizike dhe persona juridike	lek
Burime te tjera	lek
Totali i burimeve	0 lek
Shpenzime(perdorime)	lek
Marrje salla me qira	lek
Reklama televizive	lek
Reklama ne radio	lek
Shpenzime telefonike	lek
Shpenzime per postera, fletevolante, fletepalosje	lek
Shpenzime kancelarie	lek
Shpenzime per karburant	lek
Totali i shpenzimeve	lek
Teprica e burimeve neto	0 lek
	0 lek

"PARTIA ALEANCA DEMOKRATIKE SHOIPTARE"

Z. EDUART ABAZI



TË DHËNA TË PËRGJITHSHME MBI SUBJEKTIN ZGJEDHOR

Subjekti zgjedhor Partia Aleanca Demokratike eshte rregjistruar me Urdher te Ministrise se Drejtesise nr.13/1 date 03/11/1992 dhe me Vendim nr.2710 date 15/03/2013 te Gjykates se Rrethit Tirane.

Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatëse të Ligjit Nr. 8580 datë 17.02.2000 "Për Partitë politike" neni 9, 10, 11 e të tjerë.

Qëllimi dhe objektivat e kësaj Partie gjejnë pasqyrim të qartë në Programin dhe Statutin e saj. Subjekti zgjedhor Partia Aleanca Demokratike Shqiptare është një bashkim politik i qytetarëve shqiptarë e cila e ushtron veprimtarinë e saj në të gjithë teritorin e Republikës së Shqipërisë.

Qendra e Partisë Aleanca Demokratike Shqiptare eshte në Tiranë.

Objekti i veprimtarisë:

Partia Aleanca Demokratike Shqiptare perpiqet dhe synon ndertimin dhe konsolidimin e shtetit te se drejtes, barazine per te gjithe shtetasit,dhe ekuilibrimin e Politikes Shqiptare. Ajo mbron te drejtat dhe lirate e te gjithe shtetasve dhe ne vecanti te drejtat e pakicave kombetare, me te cilat mban maredhenie te ngushta dhe bashkerendon veprimtarine me shoqatat dhe organizatat qe perfaqesojne keto pakica.

Gjithashtu ne statut jane percaktuar te drejtat dhe detyrat e anetareve te partise. Drejtimi i Partise behet nga Kryesia e Partise Administrimi I saj behet nga Kryetari I Partise

Burimet e financimit janë:

- Buxheti i Shtetit financiar për fushatë (0) leke.
- Kuotat e antaresise jane (0) lekë.

1. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE DHE RREGULLAVE KRYESORE KONTABËL

a. Mënyra e Përgatitjes së Pasqyrave Financiare.

Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet e tyre materiale, në përputhje me Normat Kombëtare të Raportimit Financiar, të cilat përfshijnë rregullat e përcaktuara në ligjin Nr. 9228 datë 29.04.2004 „Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare„ të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Pasqyrat e paraqitura në raport janë shprehur në monedhën vendase në Lekë.

b. Rregullat për vlerësimin e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Të Ardhurat.

Të ardhurat janë të pasqyruara mbi bazën e arkëtimit të burimeve të financimit të vëna në dispozicion të Partisë Aleanca Demokratike Shqiptare. Te ardhurat në total për këtë fushatë zgjedhore janë 0 lekë.

Detyrimet, ose Shpenzimet janë njohur dhe pasqyruar mbi bazën e faturave tatimore, mandat arktimëve dhe mandat pagesave dhe dokumentave orgjinale kontabël. Shpenzimet sipas analizes jane te pasqyruara te pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve, dhe shpenzimet për këtë fushatë zgjedhore jane 0 leke.

Tiranë më, 8 Nentor 2015